

VENDIM
Nr.137, datë 5.1.1998

PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË BANESAVE NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE, TË VLEFTAVE MESATARE TË TREGUT TË LIRË TË BANESAVE DHE TË KOEFICIENTIT "K"

Në zbatim të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha" neni 3, dhe bazuar në të dhënat e Entit Kombëtar të Banesave dhe të INSTAT, për vitet 1996-1997, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kostoja mesatare vjetore në shkallë republike e ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitet 1996-1997 të jetë 19.581 lekë /m² sipërfaqe banimi (shfrytëzimi).

2. Vleftha mesatare në shkallë rrethi të apartamenteve tip të tregut të lirë, për vitet 1996-1997, të jenë sipas tabelës që i bashkëngjitet këtij vendimi e që është hartuar sipas të dhënave të INSTAT-it.

3. Vleftha e koeficientit "k" të nenit 3 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha", të jenë sipas tabelës që i bashkëngjitet këtij vendimi.

4. Të dhënat e pikave 1 deri 3 të përdoren nga Banka e Kursimeve në zbatim të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 1998.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano

VLEFTA E KOEFICIENTIT "K" SIPAS NENIT 3 TË LIGJIT NR.8030, DATË 15.11.1995
"PËR KONTRIBUTIN E SHTETIT PËR FAMILJET E PASTREHA"

Nr	Rrethi	Vleftha e koeficientit "K"
1	Berat	0.92
2	Bulqizë	0.26
3	Delvinë	0.71
4	Devoll	0.84
5	Dibër	0.53
6	Durrës	1.00
7	Elbasan	0.62
8	Fier	0.80
9	Gramsh	0.39
10	Gjirokastër	1.00
11	Has	0.34
12	Kavajë	0.90
13	Kolonjë	0.50
14	Korçë	0.93
15	Krujë	0.57
16	Kuçovë	0.77
17	Kukës	0.40
18	Laç	0.49
19	Lezhë	0.77
20	Librazhd	0.51
21	Lushnjë	0.51

22	Malësi e Madhe	0.66
23	Mallakastër	0.58
24	Mat	0.62
25	Mirditë	0.29
26	Peghin	0.75
27	Përmet	0.66
28	Pogradec	0.80
29	Pukë	0.32
30	Saranda	1.00
31	Skrapar	0.39
32	Shkodër	0.73
33	Tepelenë	0.32
34	Tirana	1.00
35	Tropojë	0.41
36	Vlorë	1.00